LIGJ
Nr. 140/2014

PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT TË LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN E AGRIKULTURËS PËR PROGRAMIN "MALET DREJT TREGUT"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi i letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Agrikulturës, për programin "Malet drejt tregut".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8772, datë 4.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Faks nr. 00355 4 222 8494

Drejtuar: Shkëlqesisë së Tij
Shkëlqim Cani
Ministër i Financave i Republikës së Shqipërisë
Ministria e Financave
Tiranë, Shqipëri

Për dijeni: z. Nezir Haldeda
Zëvendësministër i Financave i Republikës së Shqipërisë
Ministria e Financave
Tiranë,Shqipëri
Faks nr. 00355 4 22558435

Nga: Khalida Bouzar
Drejtor
Divizioni i Lindjes së Afërme, Afrikës së Veriut dhe Europës
Departamenti i Menaxhimit të Programit
IFAD

Datë: 10 prill 2014

Lënda: Shqipëri: Programi "Malet drejt tregjeve"
(Huaja MMP-IFAD Nr. 757-AL-Grant 1054-AL)
Kërkesë për shtyrjen e datës së mbylljes dhe rialokimin e fondeve

Z. Ministër

Referuar letrave tuaja të datës 13 shkurt dhe 2 prill 2014, kam kënaqësinë t'Ju informoj se IFAD-i ka aprovuar, nga njëra anë, kërkesën tuaj për shtyrjen e përfundimit dhe datave të mbylljes së Huas për programin "Malet drejt tregjeve" (MMP) përkatësisht deri më 31 dhjetor 2014 dhe 30 qershor 2015, dhe nga ana tjetër, kërkesën tuaj për rialokimin e fondeve.

Meqenëse data e re e përfundimit të Programit është data e vitit në vazhdim, IFAD-i rekomandon që kategoria VIII-shuma e paalokuar (SDP 66, 928) duhet të alokohet plotësisht për të mënjanuar rialokime shtesë në një fazë të mëvonshme.

Bashkëlidhur do të gjeni grafikun e rishikuar 2 të Marrëveshjes së Financimit.

Pranoni, Shkëlqesi, sigurinë e konsideratës sime më të lartë.

Për dijeni: Bouzar
Herlant
Lhommeau Dosje Projekti
Regjistra

Fondi Ndërkombëtar për Zhvillim Bujqësor: Via Paolo di Dono, 44 00 142 Romë, Italy
Tel.+39 06 5491 Faks.+39 06 5043463
E-mail: ifad@ifad.org Faqe interneti:www.ifad.org

Grafiku 2: Alokimi dhe tërheqja e shumave të Huas

Kategoria		Shuma e huas e alokuar (shprehur në SDR)	Shuma e grantit e alokuar e (shprehur në SDR)	% e shpenzimeve të lejueshme që duhet të financohen
I.	Punë civile	3 390 309		100% pa taksa dhe pa kontribute përfitimi
II.	Pajisje, mallra dhe mjete	120 000		100% pa taksa
III.	Asistencë teknike dhe studime a) Studime dhe sondazhe	330 000	30 000	100% pa taksa
IV.	Trajnim dhe seminare	56 928	130 000	100% pa taksa
V.	Grante a) Trajnim profesional b) Fermerët	 129 568 1 376 419	 100 000	100% pa taksa 100% pa taksa dhe pa kontribute përfitimi
VI.	Instrumenti i mbështetjes me kredi	176 776		100% pa taksa dhe pa kontribute përfitimi
VII.	Shpenzime periodike	280 000		30% (PYI) 70% (PY2) 50% (PY3) 30% (PY4) 20% (PY5) 20% (më pas), pa taksa
VIII.	Të paalokuara	0		
Totali		**5 860 000**	**260 000**	